



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 14.12.2015 në orën 21:50

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Slllobodan Petroviq, Xhavit Haliti, Arben Gashi, Luljeta Veselaj- Gutaj dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Rustem Mustafa, Vjosa Osmani, Ilir Deda dhe Time Kadrijaj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-080, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
3. **Të ndryshme.**

Teruta Sahatqija, kryetare e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-080, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

Teuta Sahatqija, kryetare, tha se pas miratimit në seancën plenare të Kuvendit me shmangie të Rregullores së punës, ky Projektligji ka kaluar leximin e parë dhe pritet që të procedohet për shqyrtim në leximin e dytë, sipas vendimit të seancës plenare. Gjithashtu tha, se ky projektligj është shqyrtuar së bashku me amendamentet e Komisioni Funksional, dhe është konstatuar se kjo fushë nuk është e rregulluar me legjislacionin e BE-së.

Projektligji me amendamente u nxor në votim, dhe pas votimit komisioni zëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 05/L-080, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 22:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetare e Komisionit,
Znj. Teuta Sahatqija**
